



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti i zbatimit të

**Masës 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro
dhe të vogla,
Nën Masa 2.1: Mbështetje për veprimtaritë zejtare
për vitin 2025**

Prill, 2026

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
Koordinimi dhe monitorimi i projekteve.....	5
PËRSHKRIMI I MASËS 2, NËN MASA 2.1	6
Qëllimi i Masës 2.....	6
Nën Masa 2.1: Mbështetje për veprimtaritë zejtare.....	6
Objektivat e Nën Masës 2.1	6
Lidhja me Nën Masat e tjera	7
Përfituesit	7
Kushtet e përgjithshme	7
VLERËSIMI I PROJEKTEVE DHE MBËSHTETJA FINANCIARE	7
Numri i projekteve dhe rezultatet kryesore	7
Analiza sipas rajoneve zhvillimore	9
Mbështetja financiare dhe shpërndarja e fondeve	10
PËRFUNDIMI.....	10
ANEKS 1 Faza e I-rë	Error! Bookmark not defined.
ANEKS 2 Faza e II-të.....	Error! Bookmark not defined.
ANEKS 3 Faza e III-të.....	Error! Bookmark not defined.

Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
PZHRB	Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar



Lista e tabelave

Tabela 1: Shpërndarja e monitorimeve sipas rajoneve, fazave dhe zyrtarëve monitorues.....	5
Tabela 2: Lista e projekteve të financuara sipas rajoneve dhe karakteristikave kryesore.....	8

Lista e figurave

Figura 1.: Vlera totale e financimit të projekteve sipas rajoneve zhvillimore (2025).....	9
---	---



HYRJE

Ky raport paraqet zbatimin e projekteve të financuara në kuadër të Nën Masës 2.1: Mbështetje për veprimtaritë zejtare, pjesë e Masës 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027.

Programi synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, në reduktimin e pabarazive ndërmjet rajoneve si dhe në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore përmes mbështetjes së veprimtarive zejtare. Një fokus i veçantë i kushtohet fuqizimit të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla si dhe krijimit të mundësive për vetëpunësim.

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një vlerësim të zbatimit të Nën Masës 2.1 gjatë vitit 2025, duke analizuar procesin e përzgjedhjes, shpërndarjen rajonale të përfituesve, nivelin e mbështetjes financiare dhe ndikimin e projekteve në zhvillimin ekonomik lokal.

Gjatë vitit 2025 janë financuar gjithsej 19 projekte në rajone të ndryshme të Republikës së Kosovës, me synim nxitjen e aktiviteteve zejtare dhe përmirësimin e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2025, në kuadër të Nën Masës 2.1 janë financuar 19 projekte, të përzgjedhura përmes një procesi konkurrues në tri faza. Fillimisht janë përzgjedhur 20 përfitues, por një nga përfituesit e përzgjedhur në fazën e II-të është tërhequr gjatë procesit të implementimit.

Vlera totale e financimit ka arritur në 45,215.92 €, ndërsa bashkëfinancimi nga përfituesit ka qenë simbolik, në vlerë prej 81.60 €, duke reflektuar një varësi të lartë nga mbështetja publike.

Projektet janë përqendruar kryesisht në sektorin e shërbimeve, me dominim të aktiviteteve në fushën e salloneve të bukurisë. Sektori i prodhimit dhe tregtisë ka qenë i përfaqësuar në një masë më të kufizuar, duke treguar një nivel të ulët diversifikimi të aktiviteteve të mbështetura.

Si rezultat i zbatimit të projekteve janë krijuar gjithsej 17 vende pune. Numri relativisht i ulët i vendeve të punës në raport me numrin e përfituesve pasqyron natyrën e bizneseve mikro dhe karakterin individual apo familjar të aktiviteteve zejtare.

Në aspektin rajonal, projektet janë përqendruar kryesisht në rajonet zhvillimore: Qendër dhe Veri, ndërsa rajonet zhvillimore: Perëndim dhe Lindje kanë pasur përfaqësim minimal.

Koordinimi dhe monitorimi i projekteve

Për të siguruar zbatimin korrekt dhe transparent të projekteve, Ministria e Zhvillimit Rajonal ka angazhuar zyrtarë monitorues të cilët kanë realizuar vizita në terren për verifikimin e implementimit të projekteve.

Monitorimi është fokusuar në:

- funksionalitetin e pajisjeve të financuara
- gjendjen e bizneseve përfituese
- verifikimin e punësimit të deklaruar
- përputhshmërinë me dokumentacionin kontraktual.

Secili projekt është monitoruar së paku një herë, duke siguruar kontroll të plotë të zbatimit.

Zyrtarët e angazhuar për monitorim ishin:

1. Hashim Ibishi – Faza e I-rë
2. Esat Elshani – Fazat e II-të dhe III-të

Në vijim paraqiten të dhënat e monitorimeve sipas rajoneve zhvillimore dhe fazave përkatëse.

Tabela 1: Shpërndarja e monitorimeve sipas rajoneve, fazave dhe zyrtarëve monitorues

Faza	Zyrtari monitorues	Rajoni	Numri i monitorimeve
I-rë	Hashim Ibishi	01 Qendër	1
		02 Veri	4
II-të	Esat Elshani	01 Qendër	1
		03 Perëndim	1
		04 Jug	3
		06 Lindje	1
III-të	Esat Elshani	01 Qendër	4
		02 Veri	2
		04 Jug	2
Gjithsej:			19

Kjo qasje e strukturuar e monitorimit ka mundësuar një mbikëqyrje të vazhdueshme dhe të standardizuar të projekteve, duke garantuar realizimin e tyre në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe përdorimin efektiv të fondeve publike.

PËRSHKRIMI I MASËS 2, NËN MASA 2.1

Qëllimi i Masës 2

Qëllimi i kësaj mase është të mbështesë zhvillimin ekonomik rajonal përmes ofrimit të mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, duke kontribuar në uljen e pabarazive ndërmjet komunave dhe rajoneve.

Kjo masë synon të krijojë stimuj për nxitjen e ndërmarrjeve të reja, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë, të mbështesë veprimtaritë zeytare dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore si dhe të ndihmojë bizneset ekzistuese në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, promovimin e eksporteve dhe reduktimin e varësisë nga importet.

Nën Masa 2.1: Mbështetje për veprimtaritë zeytare

Nën Masa 2.1 fokusohet në mbështetjen dhe zhvillimin e veprimtarive zeytare si një komponent i rëndësishëm i ekonomisë lokale dhe trashëgimisë kulturore.

Ajo synon të ruajë dhe të promovojë zanatet tradicionale, duke i përshtatur ato me kërkesat e tregut modern dhe duke rritur konkurrueshmërinë e tyre.

Përmes mbështetjes financiare, Nën Masa 2.1 kontribuon në fuqizimin e zeytarëve dhe ndërmarrjeve të vogla që operojnë në këtë sektor, duke mundësuar zgjerimin e aktiviteteve, përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe rritjen e qasjes në tregje të reja. Në këtë mënyrë, ajo kontribuon drejtpërdrejt në krijimin e vendeve të punës dhe në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në nivel lokal dhe rajonal.

Objektivat e Nën Masës 2.1

- Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm përmes promovimit të aktiviteteve tradicionale dhe zeytare;
- Ruajtja dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore përmes integritit të saj në ekonominë moderne;
- Rritja e kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve zeytare;
- Nxitja e konkurrueshmërisë së sektorit zeytar në tregun vendor dhe ndërkombëtar;
- Krijimi i mundësive të reja për punësim dhe vetëpunësim në komunitetet lokale.



Lidhja me Nën Masat e tjera

Nën Masa 2.1 është e ndërlidhur me Nën Masat e tjera të Masës 2, duke krijuar një qasje të integruar për zhvillimin ekonomik. Ajo plotësohet nga mbështetja për ndërmarrjet e reja (start-up) dhe bizneset ekzistuese, duke siguruar një zinxhir të plotë mbështetjeje për zhvillimin e sektorit privat.

Përfituesit

Përfitues të Nën Masës 2.1 janë ndërmarrjet mikro dhe të vogla që operojnë në sektorin e veprimtarive zejtare në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Këtu përfshihen zejtarët individualë, bizneset familjare dhe subjektet e tjera që kontribuojnë në prodhimin dhe promovimin e produkteve tradicionale.

Kushtet e përgjithshme

Për të përfituar nga Nën Masa 2.1, aplikantët duhet të dorëzojnë propozime që përmbushin kriteret ligjore dhe janë në përputhje me prioritetet e programit. Procesi i përzgjedhjes bazohet në vlerësimin e kapaciteteve të aplikantëve dhe potencialit të tyre për zhvillim ekonomik.

Shpërndarja e fondeve realizohet në mënyrë konkurruese dhe transparente, duke u fokusuar në projektet që kanë ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin e sektorit zejtar dhe në ekonominë lokale.

VLERËSIMI I PROJEKTEVE DHE MBËSHTETJA FINANCIARE

Ky kapitull paraqet një vlerësim të projekteve të financuara në kuadër të Nën Masës 2.1 gjatë vitit 2025, duke analizuar shtrirjen e mbështetjes dhe rezultatet e arritura. Vlerësimi fokusohet në aspektet kryesore të zbatimit të projekteve, përfshirë numrin dhe shpërndarjen e tyre sipas rajoneve zhvillimore, nivelin e mbështetjes financiare të ofruar si dhe ndikimin e tyre në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e aktiviteteve zejtare.

Numri i projekteve dhe rezultatet kryesore

Gjatë vitit 2025 janë financuar gjithsej 19 projekte, të shpërndara në rajone të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe të përzgjedhura përmes një procesi konkurrues në tri faza. Ky proces përzgjedhës është zhvilluar në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara, duke siguruar transparencë dhe barazi në vlerësimin e aplikacioneve. Projektet e financuara përfaqësojnë iniciativa të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla me potencial për zhvillim, të cilat

synojnë përmirësimin e kapaciteteve të tyre operuese dhe zgjerimin e aktiviteteve në sektorin zejtar.

Tabela 2: Lista e projekteve të financuara sipas rajoneve dhe karakteristikave kryesore

Nr.	Nr. i kontratës ¹	Rajoni zhvillimor	Shuma e financuar (€)	Bashkëfinancimi (€)	Numri i të punësuarve	Fusha e veprimtarisë
1	544	02 - Veri	2,456.00	0	1	Shërbime (sallon bukurie)
2	544	02 - Veri	2,487.00	0	2	Shërbime (sallon bukurie)
3	543	01 - Qendër	2,020.00	0	2	Shërbime (sallon bukurie)
4	540	02 - Veri	2,439.20	0	1	Shërbime (sallon bukurie)
5	542	02 - Veri	2,500.00	60.00	0	Prodhim (veshje)
6	887	03 - Perëndim	2,450.00	0	3	Prodhim (thika)
7	886	01 - Qendër	2,500.00	0	1	Shërbime (sallon bukurie)
8	885	04 - Jug	2,499.50	0	2	Shërbime (sallon bukurie)
9	884	06 - Lindje	1,950.00	0	1	Prodhim (veshje)
10	883	04 - Jug	2,480.00	21.60	0	Shërbime (sallon bukurie)
11	967	04 - Jug	2,470.00	0	0	Shërbime (sallon bukurie)
12	970	01 - Qendër	2,500.00	0	2	Shërbime (sallon bukurie)
13	974	04 - Jug	2,500.00	0	0	Shërbime (sallon bukurie)
14	972	02 - Veri	2,500.00	0	0	Shërbime (sallon bukurie)
15	968	01 - Qendër	1,910.00	0	0	Tregti (veshje)
16	973	02 - Veri	2,448.50	0	0	Shërbime (sallon bukurie)
17	969	01 - Qendër	2,134.50	0	1	Shërbime (sallon bukurie)
18	966	04 - Jug	2,471.22	0	0	Shërbime (sallon bukurie)
19	971	01 - Qendër	2,500.00	0	1	Shërbime (sallon bukurie)
Gjithsej			45,215.92	81.60	17	

¹ Për arsye të mbrojtjes së të dhënave personale, projektet janë identifikuar përmes nr. të kontratës.

Sic paraqitet në tabelë, projektet janë përqendruar kryesisht në sektorin e shërbimeve, me dominim të aktiviteteve në fushën e salloneve të bukuri. Një numër më i vogël projektsh i përket sektorit të prodhimit dhe tregtisë, duke reflektuar një nivel të kufizuar diversifikimi të aktiviteteve të mbështetura.

Sa i përket punësimit, shumica e projekteve kanë krijuar një numër të kufizuar të vendeve të punës, duke reflektuar natyrën e bizneseve mikro dhe aktiviteteve individuale ose familjare.

Analiza sipas rajoneve zhvillimore


Zbatimi i projekteve ka gjeneruar rezultate konkrete në zhvillimin e aktiviteteve zejtare dhe në fuqizimin e bizneseve të vogla.

Ndër rezultatet kryesore veçohen:


- krijimi i 17 vendeve të punës;
- përmirësimi i kapaciteteve operuese përmes pajisjeve dhe mjeteve të reja;
- rritja e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve;
- krijimi i mundësive për vetëpunësim dhe formalizim të aktiviteteve ekzistuese.

Përveç rezultateve direkte ekonomike, projektet kanë ndikuar edhe në shpërndarjen rajonale të zhvillimit.

Figura 1.: Vlera totale e financimit të projekteve sipas rajoneve zhvillimore (2025)



Projektet janë përqendruar kryesisht në rajonet zhvillimore: Qendër dhe Veri, me nga 6 projekte secila, të ndjekura nga rajoni zhvillimor Jug me 5 projekte. Rajonet zhvillimore: Perëndim dhe Lindje kanë pasur përfaqësim më të ulët, me nga një projekt të financuar.



Kjo shpërndarje tregon një koncentrim të mbështetjes në disa rajone, duke reflektuar nivelin e aplikimeve dhe kapacitetet ekzistuese të bizneseve. Në këtë kontekst, paraqitet nevoja për një shpërndarje më të balancuar rajonale në të ardhmen.

Mbështetja financiare dhe shpërndarja e fondeve

Në kuadër të thirrjes publike për aplikim, Ministria e Zhvillimit Rajonal kishte planifikuar shpërndarjen e fondeve në vlerë prej 50,000.00 €.

Në këtë kuadër, MZHR ka financuar deri në 100% të vlerës së projekteve të përzgjedhura. Megjithatë, aplikantët kanë pasur mundësinë të bashkëfinancojnë projektet e tyre deri në 20% të vlerës së përgjithshme. Shuma minimale e mbështetjes për projekt ka qenë 1,000.00 €, ndërsa shuma maksimale 2,500.00 €.

Niveli shumë i ulët i bashkëfinancimit tregon kapacitete të kufizuara financiare të përfituesve dhe një varësi të theksuar nga mbështetja publike, çka mund të ndikojë në qëndrueshmërinë afatgjatë të projekteve.

PËRFUNDIMI

Zbatimi i Nën Masës 2.1 gjatë vitit 2025 ka rezultuar në mbështetje konkrete për zhvillimin e sektorit zejtar dhe fuqizimin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në Republikën e Kosovës. Përmes financimit të 19 projekteve, programi ka kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve operuese të bizneseve përfituese, rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve si dhe në krijimin e mundësive për vetëpunësim. Gjithashtu, janë krijuar 17 vende pune, duke reflektuar ndikimin e drejtpërdrejtë të programit në zhvillimin ekonomik vendor.

Megjithatë, analiza e të dhënave evidenton disa sfida, përfshirë nivelin shumë të ulët të bashkëfinancimit nga përfituesit dhe përqendrimin e projekteve kryesisht në sektorin e shërbimeve dhe në rajone të caktuara zhvillimore. Këta faktorë sugjerojnë nevojën për rritjen e diversifikimit sektorial dhe për një shpërndarje më të balancuar rajonale të mbështetjes në të ardhmen.

Në përgjithësi, programi ka dëshmuar rëndësi të konsiderueshme në nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe në mbështetjen e veprimtarive zejtare, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm. Përmirësimet e mëtejshme në dizajnin dhe zbatimin e programit pritet të rrisin efektivitetin dhe ndikimin e tij në vitet në vijim.